



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1681/2 Prot.

Tiranë, më 17.12.2025

V E N D I M

Nr. 299, Datë 17.12.2025

Bazuar në Ligjin nr. 10221, datë 10.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 301, datë 27.11.2025, e bërë nga z. A.B kundër z. K.P, me detyrë Administrator i Njesisë Administrative nr. 8, Tiranë me pretendimin për diskriminim për “*çdo shkak tjetër¹*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me email-in datë 10.12.2025, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Prej 7 vitesh jam punonjës në Njësine Administrative nr. 8, dhe prej vitit 2024 në pozicionin Specialist i Informimit Qytetar. Me datë 28.07.2025 jam certifikuar nga ASPA, si nëpunës civil.*

Me datë 20.11.2025, gjatë ushtrimit të detyrës sime dhe në përputhje me procedurat ligjore, regjistrova kërkesën e një qytetareje që bën pjesë në kategorinë “familje në nevojë”, e cila kërkonte akomodim në banesë sociale. Pasi veprova sipas detyrës, u kontaktova nga punonjësja e protokollit dhe më pas u thirra në zyrë nga Administratori i Njesisë, i cili është funksionar i emëruar politik. Në bisedën që pasoi, u përballa me tone të larta, me fjalor të papërshtatshëm dhe me deklaratat që krijuan ndjesi të fortë presioni dhe pasigurie. Më është thënë ndër të tjera: “Pse ja mbajte kërkesën?”, “Çfarë t’i ofrojmë ne?”, “Përgjigjen do ja kthesh ti tani, meqë ja

¹ Pa përcaktuar një veçori apo karakteristikë personale.

mbajte kërkesën”, si edhe mu drejtua duke më thënë shprehjen “këto gjëra marrin jetë njeriu”. Këto fjalë kanë krijuar tek unë ndjenjën e një kërcënimi të drejtpërdrejtë dhe një gjendje frike në ambientin e punës.

Dua të vë në dukje se për shkak të mënyrës së komunikimit, pozicionit hierarkik të personit dhe natyrës së deklaratave të bëra, jam ndier i dhunuar psikologjikisht, i kërcënuar për jetën, si dhe i cenuar në integritetin tim profesional. Që prej këtij incidenti ndihem nën presion të vazhdueshëm në ambientin e punës. Dje, mbas incidentit të ndodhur kam njoftuar me email instancat më të larta të Bashkisë Tiranë dhe më vonë më ka ardhur në zyrë financierja e Njesisë si dhe njëkohësisht përgjegjëse (e deleguar) direkte e sektorit tim, duke më informuar që Administratori do më bëjë vërejtje. Ditën e sotme, pa u dhënë asnjë njoftim paraprak, pa u zhvilluar një proces shpjegimi, pa një fazë hetimi apo shqyrtimi administrativ, jam njoftuar me një shkresë nr. 2924, datë 21.11.2025, të firmosur nga Administratori, sipas së cilës ndaj meje është vendosur masa disiplinore “Vërejtje”, për performancë të ulët në përmbushjen e detyrave funksionale dhe mungesë të etikës profesionale në komunikim dhe sjellje.

Gjithashtu, dua të informoj se ndodhen edhe punonjës të tjerë që shprehin pasiguri, frikë dhe presion, por nuk guxojnë të dalin hapur për shkak të klimës së tensionuar dhe mënyrës së drejtimit, siç ka edhe punonjës që kam dijeni që kanë bërë gabime të ndryshme dhe nuk është marrë ndaj tyre asnjë masë disiplinore.

1. Trajtim selektiv në masat disiplinore.

Në Sektorin e Shërbimit Social për fëmijën B.T është bërë ankesë zyrtare, punonjësja e shërbimit social nuk i ka bërë aplikimin qytetarit për statusin e jetimit, duke i shkaktuar humbje të përfitimeve financiare. Administratori nuk ka marrë asnjë masë, duke treguar standard të dyfishtë dhe tolerancë të plotë ndaj punonjësve të caktuar. Ky është qartësisht një trajtim i pabarabartë.

2. Favorizim i punonjësve të tjerë.

Ndërkohë, kërkesat mbahen në mënyrë preferenciale nga punonjës të tjerë (jashtë kompetencave të tyre ligjore bazuar në përshkrimin e tyre të punës) dhe më pas, kur është krijuar problemi Administratori më ka thirrur mua në zyrë duke më bërë titur edhe pse nuk kam patur asnjë përgjegjësi ligjore, sepse kam qenë me raport (kërkesë e mbajtur me shkelje nga ish-juristja me datë 29.04.2025).

Gjithashtu, punonjësja e protokollit mban herë pas here kërkesat e qytetarëve preferenciale, jo më larg se dje me datë 25.11.2025 ka mbajtur kërkesën (për nenin 6) të z. F. G.

Ndërkohë, kam vënë re që punonjësit e tjerë kanë hyrje dalje jo në përputhje të zbatimit të orarit zyrtar gjë e cila verifikohet nga pamjet filmike (kamerat e institucionit).

Në dy sektor janë komanduar si përgjegjëse sektori dy specialiste, të cilat nuk kanë arsimin e duhur. Pra, kjo tregon qartazi favorizim të të tjerëve dhe penalizim ndaj meje, si dhe ndërkohë që të tjerët promovohen në pozicione drejtuese pa plotësuar kriteret arsimore dhe profesionale, mua më është vendosur vërejtje disiplinore e padrejtë.

3. Klima e frikës dhe presionit në punë.

Pas incidentit kryesor, jam ndjerë i kërcënuar dhe nën presion të vazhdueshëm në ambientin e punës. Kjo gjendje më ka shkaktuar edhe probleme shëndetësore, pasi këto ditë kam qenë me tension të lartë dhe probleme kardiake duke marrë edhe mjekim. Gjithashtu, informoj se punonjës të tjerë kanë shprehur pasiguri dhe frikë, por nuk guxojnë të flasin për shkak të klimës së krijuar.

Sa më lart, vlen të theksoj se unë e ndjej veten të diskriminuar, pasi kam marrë masë disiplinore të padrejtë, ndërkohë që të tjerët promovohen padrejtësisht në një pozicion pune duke patur mospërputhje me kriteret ligjore dhe ndërkohë nuk janë ndëshkuar ato që kanë kryer gabime në detyrat funksionale.

Në përfundim, të gjitha këto raste më bëjnë të ndjehem i diskriminuar në formën e trajtimit të pabarabartë, të keqpërdorimit të autoritetit dhe vendimmarrjes selektive, duke cenuar dinjitetin dhe integritetin tim profesional, si nëpunës civil”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe verifikimin e procedurës së vendosjes së masës disiplinore “Vërejtje” dhe anulimin e saj.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

Për këtë arsye, me e-mail-in, datë 09.12.2025, inspektori i çështjes, ka kërkuar ndër të tjera nga subjekti ankues, shpjegime, fakte dhe prova për të identifikuar shkakun “*çdo shkak tjetër*”.

Subjekti ankues me email-in datë 10.12.2025, dërgoi informacion dhe dokumentacion lidhur me ankesën, por nuk dërgoi shpjegime apo dokumentacion për të identifikuar shkakun e diskriminimit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore

të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Vendimmarrja e KMD-së arsyetohet dhe argumentohet mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “*çdo shkak tjetër*”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të tij.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut të mbrojtur”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këtë “shkak”.

Përsa i takon pretendimit të ankuesit për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo

trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkaku të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë shkaqesh². Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohej mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh³.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bënë të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike

² Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

³ Neni 14, i KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesi nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet nëse:, ç) ... është haptazi e pabazuar”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁴.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 301, datë 27.11.2025, paraqitur nga z. A.B, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁴ Për analogji citojmë Vendimet: nr. 283, datë 19.11.2024, nr. 84, datë 14.04.2025 dhe nr. 92, datë 24.04.2025, të KMD-së.